

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: (I.K. I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:(206/71100-26-2528-1-2-1)

Sa i përket tenderit për(*Furnizim me UPS*)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ARITECH SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan, përball QMI

(Adresa)

Graçanicë

10500

(Vendi)(Kodi postar)

+383 38 600 500

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Fahri Avdiu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

fahri@aritechks.com

(Adresa elektronike)

15.06.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate eshte publikuar ne e-prokurim me dt. 22.04.2026

Afati i fundit per dorezim te ofertes eshte me date 15.05.2026 h 13:00.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Kjo ankesë paraqitet pas zhvillimit të procedurës paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes pranë Autoritetit Kontraktues. Ankuesi më 08.05.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër dokumenteve të tenderit, e cila me vendimin e datës 13.05.2026 është refuzuar si e paafatshme. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankesë në OSHP, e regjistruar me nr. 2026/0318, pas së cilës eksperti shqyrtues ka konstatuar se kërkesa duhej të trajtohej si e afatshme dhe të shqyrtohej sipas meritës. Me vendimin e datës 02.06.2026, OSHP ka aprovuar pajtimin e palëve dhe ka obliguar AK-në të implementojë rekomandimet e ekspertit. Në zbatim të këtij vendimi, AK më 04.06.2026 ka nxjerrë vendim të ri me të cilin kërkesa për rishqyrtim është aprovuar vetëm pjesërisht. Duke mos u pajtuar me pjesën refuzuese të këtij vendimi dhe me arsyetimin e dhënë nga AK, Ankuesi paraqet këtë ankesë brenda afatit ligjor, duke kërkuar shqyrtimin e plotë të pretendimeve ankimore nga OSHP.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Neni 28
Specifikimet teknike

3. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.
7. **Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë**, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"

Neni 108/A
Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.
- 3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në zbatim të vendimit të OSHP-së nr. 2026/0318, Autoriteti Kontraktues ka rishqyrtuar kërkesën tonë dhe me vendimin e datës 04.06.2026 e ka aprovuar atë vetëm pjesërisht.

Edhe pse AK ka pranuar disa nga pretendimet tona dhe ka bërë korrigjime të caktuara në dokumentacionin e tenderit, pjesa më e madhe e pretendimeve tona është refuzuar pa arsyetim të mjaftueshëm teknik dhe juridik.

Aritech Shpk nuk kundërshton nevojën e Autoritetit Kontraktues për të siguruar pajisje cilësore, të sigurta dhe të përshtatshme për funksionimin e laboratorëve dhe sistemeve kritike të energjisë rezervë. Megjithatë, kërkesat teknike duhet të jenë proporcionale, objektive dhe të lejojnë konkurrencë efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë që ofrojnë produkte ekuivalente.

Vendimi i AK-së nuk demonstroi se kërkesat e kontestuara janë të domosdoshme për realizimin e qëllimit të prokurimit dhe nuk përmban analizë teknike apo hulumtim tregu që do të justifikonte kufizimin e konkurrencës.

Kërkesa për EUR1 mbetet kufizuese dhe në kundërshtim me LPP-në

AK ka refuzuar pretendimin tonë lidhur me kërkesën për EUR1 duke arsyetuar se ajo lidhet me sigurinë e zinxhirit të furnizimit dhe harmonizimin me standardet evropiane. Megjithatë, EUR1 nuk është standard teknik dhe nuk dëshmon cilësinë, sigurinë, performancën apo jetëgjatësinë e baterisë.

EUR1 është dokument i origjinës preferenciale dhe lidhet me procedurat doganore, jo me karakteristikat teknike të produktit.

Një bateri mund të jetë plotësisht në përputhje me IEC 60896-21/22, CE dhe standarde të tjera ndërkombëtare pa qenë e pajisur me EUR1. Për këtë arsye kërkesa për EUR1 kufizon konkurrencën pa pasur lidhje të drejtpërdrejta me funksionalitetin e produktit dhe bie ndesh me nenin 7 dhe nenin 28 të LPP-së.

Kërkesa Eurobat “Very Long Life 12+” mbetet kufizuese

AK ka refuzuar pretendimin tonë lidhur me klasifikimin Eurobat Very Long Life 12+, duke pretenduar se ekzistojnë disa prodhues që e përmbushin këtë kriter.

Megjithatë, çështja nuk është numri i prodhuesve që mund ta plotësojnë kriterin, por fakti se pranueshmëria është lidhur me një klasifikim specifik dhe jo me performancën e produktit.

Prodhues të ndryshëm mund të dëshmojnë jetëgjatësi të projektuar 12 vite ose më shumë përmes datasheet-it ose dokumentacionit teknik, pa përdorur domosdoshmërisht klasifikimin Eurobat Very Long Life 12+.

Prandaj kërkesa duhet të lejojë dëshmi ekuivalente për jetëgjatësinë e projektuar të baterisë.

Përshkrimi i elektrodave dhe konstruksionit favorizon produkte të caktuara

AK ka refuzuar pretendimet tona lidhur me përshkrimin e elektrodave dhe elementeve konstruktive të baterisë.

Megjithatë, specifikimi aktual nuk fokusohet në performancën e baterisë por në mënyrën konkrete të prodhimit të saj.

Prodhues të ndryshëm mund të arrijnë performancë të njëjtë ose më të mirë përmes teknologjive dhe proceseve të ndryshme prodhuese.

Kërkesat që lidhen me plumbin 99.99%, formën e elektrodave dhe elemente të tjera të brendshme nuk janë të domosdoshme për të garantuar funksionalitetin e kërkuar dhe kufizojnë konkurrencën në favor të një grupi të kufizuar produktesh.

Kërkesa për ABS UL94-V0 nuk lejon alternativa ekuivalente

AK ka mbajtur në fuqi kërkesën për materialin ABS UL94-V0.

Megjithëse siguria kundër zjarrit është e rëndësishme, AK nuk ka lejuar materiale ekuivalente që mund të ofrojnë nivel të njëjtë ose më të lartë sigurie.

Në mungesë të formulimit “ose ekuivalent”, kjo kërkesë kufizon pa nevojë konkurrencën dhe bie ndesh me nenin 28 të LPP-së.

Kufizimi i datës së prodhimit në maksimum 4 muaj nuk është i arsyetuar

AK ka refuzuar pretendimin tonë lidhur me kërkesën që data e prodhimit të baterive të mos jetë më e vjetër se 4 muaj.

Megjithatë, bateritë VRLA-AGM mund të ruhen për periudha dukshëm më të gjata sipas rekomandimeve të prodhuesve, pa ndikuar në performancën e tyre.

Gjendja reale e baterisë vlerësohet në bazë të parametrave teknike, kushteve të ruajtjes dhe garancisë së prodhuesit, e jo vetëm në bazë të datës së prodhimit.

AK nuk ka paraqitur asnjë analizë teknike që dëshmon se kufiri prej 4 muajsh është i domosdoshëm për realizimin e qëllimit të kontratës.

Efekt i kumulativ i kërkesave teknike kufizon konkurrencën

Edhe nëse secila kërkesë individualisht do të mund të arsyetohej, kombinimi i tyre krijon një efekt të qartë kufizues.

Kombinimi i kërkesave:

- EUR1;
- Eurobat Very Long Life 12+;
- plumb 99.99%;
- ABS UL94-V0;
- kufizimi 4-mujor i datës së prodhimit;
- standardet dhe karakteristikat e tjera shumë specifike;

e ngushton ndjeshëm rrethin e produkteve dhe operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në procedurë.

AK nuk ka paraqitur asnjë analizë tregu dhe asnjë dëshmi që vërteton se këto kërkesa janë të domosdoshme dhe proporcionale.

Kërkesa drejtuar OSHP-së

Duke u bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga OSHP që:

1. Të aprovojë ankesën si të bazuar;
2. Të anulojë pjesën refuzuese të vendimit të AK-së të datës 04.06.2026;
3. Të konstatojë se kërkesat e kontestuara nuk janë në përputhje me nenin 7 dhe nenin 28 të LPP-së;
4. Të urdhërojë AK-në të riformulojë specifikimet teknike në mënyrë që të lejojë produkte dhe dëshmi ekuivalente;
5. Të largojë kërkesën për EUR1 si kriter eliminues;
6. Të lejojë dëshmi ekuivalente për jetëgjatësinë e projektuar të baterive;
7. Të rishikojë kërkesën për datën e prodhimit të baterive;
8. Të urdhërojë zgjatjen e afatit për dorëzim të ofertave pas korigjimit të dokumentacionit të tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Zbatimi i specifikimeve të kundërshtuara i shkaktonte ose rrezikon t'i shkaktojë ARITECH SH.P.K. dëm material, sepse e kufizon mundësinë për të konkurruar me produkte ekuivalente që janë teknikisht të përshtatshme dhe konkurruese në çmim. Nëse specifikimet mbeten siç janë, operatori ekonomik mund të përjashtohet nga pjesëmarrja jo për shkak të mungesës së kapacitetit apo cilësisë, por për shkak të kërkesave që nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me performancën funksionale të produktit.

Kjo sjell humbje të mundësisë për ofertim, shpenzime të panevojshme për sigurimin e dokumentacionit apo produkteve të përshtatura artificialisht, rritje të çmimeve dhe kufizim të konkurrencës së lirë. Parashtruesi i ankesës nuk paraqet me këtë ankesë kërkesë të veçantë për kompensim monetar, por e rezervon këtë të drejtë sipas dispozitave në fuqi, nëse dëmtohet nga vazhdimi i procedurës në kundërshtim me ligjin.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të
- d) Kërkesa per Rishqyrtim e datës 08.05.2026
- e) Vendimi i AK-se rreth kerkeses per Rishqyrtim date 13.05.2026

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*